



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 16 Shkurt 2023

Nr: 57

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NDAJ Z. ARTAN LAME, DREJTOR I AGJENCISË  
SHTETËRORE TË KADASTRËS, NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 16 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim denoncimin që u përket:

**SUBJEKTI:** Z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

**OBJEKTI:** Shqyrtim administrativ i denoncimit ndaj z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23, 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” dhe vendimi nr. 9 datë 24.12.202 “Për rregullat e raportimit të veprtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të

burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### KONSTATOJ:

- 1- Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 21.1.2023, në adresë të e-mail të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për organizmin e veprimtarisë publike si vijon: *“Sipas një kronike të transmetuar në media (<https://tvklan.al/legalizimet-e-pronave-ne-gose-e-spille/>), në datë 13 Janar 2023, pra në ditën që nisi afati katër-mujor, kur disa aktivitete janë të ndaluara, Drejtori i Agjencisë së Kadastrës Shqiptare z. Artan Lame, shpërndau certifikata legalizimi për banorë të Gosës dhe Spillesë në një aktivitet publik. Gjithashtu, theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Informacioni që disponohet në lidhje me këtë aktivitet është vetëm kronika e transmetuar në mediat Klan TV dhe Klan Plus TV, në datë 13 Janar 2023. Bashkëlidhur është dërguar prova link:*  
<https://www.youtube.com/watch?v=dp4GxZ0cAQU> .
- 2- Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktojnë kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 5- Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti denoncues përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.
- 6- Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
- 7- Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijoje procedurën administrative ndaj z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore dhe Kadastrës, ndaj të cilit ekzistojnë dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari publike, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e

Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- 8- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë indicie të besueshme se drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është përfshirë në veprimtari publike të ndaluar, e cila vjen në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përkatësisht me nenin 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja "b" i cili ndalon shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe cfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën" në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- 9- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 434 prot., datë 26.01.2023, me lëndë "Kërkesë për informacion" i ka kërkuar z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, informacion sqarues në lidhje me veprimtarinë publike, objekt denoncimi.
- 10- Nëpërmjet shkresës nr. 2112/1 prot., datë 31.01.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 434/1 prot., datë 01.02.2023, z. Artan Lame pretendon se *"Aktiviteti objekt denoncimi është kryer në zbatim të kalendarit të aktiviteteve që ASHK ka miratuar në fillim të vitit, për të promovuar punën e saj funksionale. Aktiviteti është organizuar ditën e enjte, datë 12.01.2023, ora 15:00, në qendër të fshatit Gosë, të qytetit të Rrogozhinës. Tematika e takimit ka qenë, njoftimi i përfundimit të procesit të legalizimit për Njësinë Administrative Gosë, fshati Spille, të Njësisë Administrative Kryevidh të qytetit të Rrogozhinës. Në këtë aktivitet kanë qenë të pranishëm punonjësit e drejtorisë vendore të ASHK- së Kavajë si dhe qytetarë të dy njësive"*.
- 11- Bashkëngjitur shkresës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është vënë në dispozicion të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet formatit elektronik CD, "Urdhëri nr. 651 prot., datë 11.01.2023 "Për organizimin e takimit me banorë në Gosë dhe Spille" si dhe të dhëna digjitale të fotove të kryera gjatë aktivitetit.
- 12- Neni 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja "a" e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndalon *"a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve"*. Në rastin konkret veprimtaria publike është kryer më 12.01.2023, vërtetuar kjo nga shkresa nr. 2112/1 prot., datë 31.01.2023 të ASHK-së, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me

shkresën nr. 434/1 prot., datë 01.02.2023, dhe urdhërit nr. 651 prot., datë 11.01.2023 “Për organizimin e takimit me banorë në Gosë dhe Spille”. Legjislatori konsideron të ndaluar shpërndarjen e lejeve të legalizimeve në veprimtari publike në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve, respektivisht nga data 13.01.2023,3 deri në datën e zgjedhjeve.

13- Për sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se veprimtaria publike e kryer nga z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

### **V E N D O S :**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Artan Lame, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**